



**Republika e Kosovës**  
*Republika Kosovo - Republic of Kosovo*  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
*Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority*



Nr. 73/2023

Datë: 03.08.2023

Mbështetur në nenin 3 paragrafët 2, 3 dhe 7, neni 4, neni 5, neni 9, neni 26, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, neni 27, neni 36, paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, dhe 1.2, neni 37, neni 38, neni 39 si dhe neni 55 paragrafi 2 me nën paragrafin 2.1 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, ka kryer shqyrtimin paraprak të hetimit në tregun përkatës të shitjeve me pakicë të ndërmarrjeve (marketeve), të cilat kanë ndikim të ndjeshëm në tregun relevant. Me dyshimin e bazuar për Marrëveshje të ndaluara (kartele) apo Praktikë të bashkërenduar si dhe Keqpërdorim të Pozitës Dominuese të përbashkët nga ndërmarrjet ose grupim i ndërmarrjeve për produktin Vaj Ushqimor i Lulediellit, lidhur me çështjen Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur, më datë 03.08.2023, merr këtë:

## KONKLuzion

### I. Për fillimin e procedurës hetimore ndaj ndërmarrjeve:

1. ETC Sh.P.K. NUI: 810497976 adresa: Zona Industriale, Pejë, PN;
2. Viva Fresh Sh.P.K. NUI: 810670390 adresa: Magjistrallja Prishtinë - Lipjan, PN;
3. Proex Sh.P.K. Hipermarket "INTER EX", NUI: 810806862 adresa: Rr. Fehmi Lladrovci nr. 32, Prishtinë;
4. Super Viva Sh.P.K. NUI: 810800385 adresa: Zona Industriale; Prishtinë, PN;
5. Emona Center Shpk. NUI: 810693839, adresa: Rr. Dëshmorët e Kombit, Vushtrri, PN.

### II. Autoriteti i Konkurrencës kërkon nga ndërmarrjet e lartcekura, si në pikën I të dispozitivit të këtij konkluzioni që në afat prej **30 ditësh** t'i sjellin në zyrat e Autoritetit këto dokumente:

- a) Informacionet e biznesit, certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën e numrit fiskal);
- b) Pasqyrat financiare për vitet 2021 dhe 2022;
- c) Librin e blerjes për vitet 2021 dhe 2022;
- d) Librin e shitjeve për vitet 2021 dhe 2022;

- e) Çmimet ditore të shitjes me pakicë në formë fizike të kuponëve fiskal për secilën pikë të shitjeve për të gjitha brendet e vajit ushqimor të lulediellit nga data 20 Shkurt deri më 20 Mars 2022;
- f) Çmimet ditore të blerjes pa TVSH nga Janar 2022 deri më Prill 2022;
- g) Stoqet e datës 07 Mars 2022 me çmimin kushtues pa TVSh të vajit ushqimor të lulediellit;
- h) Stoqet e datës 31.12.2021 dhe 31.12.2022; me çmimin kushtues pa TVSh të vajit ushqimor të lulediellit;

**III.** Në rast se, palët në procedurë nuk i dorëzojnë komentet dhe dokumentet e kërkuara si në pikën **II** në dispozitiv të këtij konkluzioni apo dorëzojnë dokumente të pa-sakta apo të rreme, Autoriteti do të konstatojë shkeljen e këtij ligji dhe do t'u shqiptojë palëve sanksionin administrativ deri në 1% të qarkullimit vjetor të vitit paraprak dhe më pastaj do të vazhdojë procedurën hetimore duke i përdorur mjetet tjera ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

**IV.** Ky konkluzion hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

### **A r s y e t i m**

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, *(tutje referuar si: Autoriteti)* ka filluar monitorimin e tregut relevant sipas detyrës zyrtare pas çrregullimit të tregut përkatës dhe krijimit të panikut tek qytetarët, reagimit të mediave elektronike dhe TV nacionale, si: Portali Indexonline, Klan Kosova, Albinfo Ch, Insajder, Telegraf, Gazeta Express, Balkanweb, Radio Evropa, Koha Ditore, Epoka e Re, Gazeta Projekti, Kallxo.com, Sinjali.com, të cilat me datën 8, 9, 10 Mars 2022 kanë informuar opinionin se marketet pikat e shitjes për produktin Vajin Ushqimor të Lulediellit janë duke e shitur me çmimin e njëjtë të fiksuar prej 3.49€ si dhe çmime tjera të ngritura në mënyrë paralele. Autoriteti është informuar edhe nga autoritetet publike si (Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Policia e Kosovës, etj).

#### **PALË NË PROCEDURË:**

Palët në procedurë të zhvilluar nga Autoriteti i Konkurrencës konsiderohen ndërmarrjet të cilat janë të cekura në pikën **I** të dispozitivit.

#### **TREGU PËRKATËS APO RELEVANT**

- Tregu gjeografik - duke iu referuar nenit 4, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për përcaktimin e tregut përkatës Nr. 01/2023, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Kosovës.
- Tregu i produktit - do të konsiderohet, Vaji Ushqimor Luledielli *(të gjitha markat tregtare apo brendet)*.



Produkti Vaji ushqimor shitet në një supermarket, i cili është një dyqan vetëshërbimi që zakonisht specializohet në shitjen e një sërë sendesh ushqimore dhe të domosdoshme shtëpiake. Një hipermarket është një dyqan më i madh me pakicë që ofron një gamë më të gjerë produktesh, duke përfshirë sende ushqimore, veshje, pajisje elektronike, sende shtëpiake dhe më shumë.

## **PËRSHKRIMI I GJENDJES FAKTIKE:**

Autoriteti, pas mbledhjes së informatave lidhur me dyshimet për Marrëveshje të ndaluar ( kartelet) apo Praktikë të Bashkërenduar, si dhe Keqpërdorim të Pozitës Dominuese të përbashkët nga ndërmarrja ose grupim i ndërmarrjeve, për shkak se para ngritjes së çmimeve të shitjeve me pakicë nga supermarketet dhe hipermarket, që kanë ndikim të ndjeshëm në tregun përkatës, të cilat kanë ruajtur stoqet e tyre në depo me qëllim që, më pastaj do t'i plasojnë në treg me çmime më të larta krahasuar me çmimet e shitura para datave 8, 9, dhe 10 Mars të vitit 2022, edhe pse kostoja e furnizimit nuk kishte ndryshuar.

Autoriteti dyshon se: ndërmarrjet e cekura në pikën (I) të këtij konkluzioni, për shkak të Marrëveshjes së ndaluar (kartelet) apo Praktikë të Bashkërenduar si dhe Keqpërdorimit të Pozitës Dominuese të përbashkët nga ndërmarrja ose grupim i ndërmarrjeve, për pasojë konsumatori nuk kishte mundësi të zgjedhjes, për faktin se ndërmarrjet hipermarkete dhe supermarketet si në pikën (I) të konkluzionit, në periudhën Shkurt dhe Mars 2022 kishin vendosur në mënyrë të koordinuar dhe të menjëhershëm çmimet e shitjes së vajit ushqimor, si dhe kishin kufizuar shitjet e tyre që më pastaj i kanë shitur me çmime më të larta të cilat nuk e kanë arsyetuar koston.

Nga përshkrimi i rrethanave dhe praktikave rezulton se, rritja në të njëjtën kohë për periudhën e lartcekur të çmimit të shitjes së vajit ushqimor të lulediellit, nga ndërmarrjet në tregun përkatës, mund të bie në kundërshtim me nenin 5, paragrafi (1) nën paragrafi (1.1) të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi kanë caktuar çmimet e shitblerjes ose çdo kusht tjetër tregtimi, për të vazhduar me paragrafin (1.2) me këtë veprim kanë kufizuar ose kontrolluar prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet, si dhe nenin 9, të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, paragrafi (2) nën paragrafi (2.1) në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi kanë vendosur çmime të padrejtë të shitjes ose kushte tjera të padrejta tregtare, si dhe nën paragrafin (2.2) ndërmarrjet kanë kufizuar prodhimin, tregjet ose zhvillimin teknologjik në dëm të konsumatorëve.

Andaj, nga sa u tha më lartë, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 37 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, vendosi si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

**Këshilla juridike:** Kundër këtij konkluzioni për fillimin e procedurës hetimore nuk është e lejuar ankesa e as padia për iniciimin e konfliktit administrativ.

**AUTORITETI I KONKURRENCËS  
KOMISIONI**



Neime Binaku - Isufi  
*Kryetare*



Kaltrina Sela  
*Nënkryetare*



Nafije Osdautaj  
*Anëtare*

*Me këtë KONKLuzion të njoftohen:*

- *Palëve në procedurë;*
- *Arkiva.*